



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 7/2021 Regjistri (JD)  
Datë. 15.10.2021

Nr. 3 i Vendimit  
Datë 20.12.2021

VENDIM  
PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES  
PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE

Kolegjit i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta</b>	<b>Schuetz</b>	<b>Gjyqtare</b>
<b>Natasha</b>	<b>Mulaj</b>	<b>Gjyqtare</b>
<b>Ina</b>	<b>Rama</b>	<b>Gjyqtare</b>

mori në shqyrtim paraparak, në dhomë këshillimi, më datë 20.12.2021, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me sekretare gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 7/2021, datë 15.10.2021, që i përket:

**KËRKUES:** Hasan Roqi

**SUBJEKT I**

**INTERESUAR:** Këshilli i Lartë Gjyqësor

**OBJEKTI:**

1. Konstatimi i pavlefshmërisë së lënies në fuqi heshturazi pa vendim njoftimi, nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës në Këshillin e Lartë Gjyqësor të vendimit nr. {\*\*\*} datë 26.05.2021 të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me magjistratin A.V., në kuadër të përkrahjes së pandëshkueshmërisë, mungesës së transparencës, ndikimit politik dhe korrupsionit, në cenim të drejtpërdrejtë të Kushtetutës së RSH, Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe vendimit 76/2000 të saj, Kodit të Procedurës Civile, ligjet e veçanta, Ligji Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese,

interesave ligjore, shëndetësore, morale e financiare të ankuesit dhe familjarëve të tij.

2. Vendosja para përgjegjësisë disiplinore, e subjekteve të interesuara mbrojtës të veprimtarisë së paligjshme të kandidatit për KLGJ, magjistratit A.V, dhe masa disiplinore edhe për këtë magjistrat. Vendosje e masës së ndalimit të tre pagave mujore për llogari të kërkuesit ndaj tre anëtarëve të Komisionit Disiplinor në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për mosrespektim të Kushtetutës së RSH dhe KEDNJ, në përkrahje të hapur të shkeljes së tyre, veprime të cilat kanë sjellë viktimizimin e familjes Roqi, duke rritur më tej stresin, për mosndëshkueshmëri të krimit në sistemin e drejtësisë dhe tejzgjatjen e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë lënë në fuqi nga Gjykata Kushtetuese, në shkelje të sigurisë juridike të ligjit të veçantë, përtej 23 vitesh.

3. Dhënia e garancisë procedurale nga Komisioni i Posaçëm i Apelit, në mbrojtje të ekzekutimit të të drejtave që rrjedhin nga vendimi 76 datë 08.11.2000 i Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit të veçantë, pikës 9, germa “ç” të Udhëzimit të KM, Nr. 3 datë 21.06.1993, për zbatimin e ligjit Nr. 7698 datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve” duke urdhëruar ekzekutimin e vendimit të saj Nr. 76/2000 dhe për shkak të zgjatjes së këtij afati prej 23 vjetësh të mosekzekutimit, por të dhunimit nga autoriteti shtetëror dhe gjykatat e ligjit, të paguajë dëmshpërblimin 100 000 lekë për çdo vit vonesë.

4. Shpërblimi i dëmit financiar dhe moral për 4 vite nga ana e kandidatit për KLGJ, magjistratit A.V, nga dita e dhënies së vendimit të tij Nr. {\*\*\*} datë 13 shtator 2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, në shumën 28.600 euro për dëmin material dhe 30.000 euro për dëmin moral.

5. Publikimi në median publike dhe në Shkollën e Magjistraturës si kasus, të vendimit të korruptuar dhe kriminal, nr. {\*\*\*}, datë 13 shtator 2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë të grabitjes së hapur të qytetarit, në shkelje flagrante të ligjit dhe Kushtetutës së RSH dhe vendimit 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, në shpërdorim të detyrës në bashkëpunim me krimin e organizuar nga lektori i magjistraturës A.V., dekretuar anëtar i Gjykatës së Lartë mbas vendimit të arkivuar me dashakeqësi ligjore, nga ILD dhe KLGJ dhe sot kandidat për KLGJ.

**BAZA LIGJORE:** Neni 131, shkronja “f”, neni 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, neni 137 dhe 179, pika 7 e Kushtetutës; Neni 6 i KEDNJ-së; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar ; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, pasi dëgjoji gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N :

### ***I. Rrethanat e çështjes***

- 1.1 Kërkuesi ka paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor (*në vazhdim KLGJ*) një ankesë, regjistruar me nr. {\*\*\*}prot, datë 09.12.2020, lidhur me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit A.V në disa procese gjyqësore ku ka qenë palë edhe kërkuesi.
- 1.2 KLGJ, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2020, ia ka përcjellë ankesën Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*në vazhdim ILD*), me argumentin se verifikimi i ankesave ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve, sipas neneve 147, 147/a dhe 147/d, të Kushtetutës si dhe të pjesës IV, nenet 193 deri 216 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është në fushën e përgjegjësisë së ILD.
- 1.3 Në ankesën drejtuar KLGJ, dhe përcjellë ILD, ankuesi Hasan Roqi ankohet ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, A.V, në dhënien e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 13.09.2017. Gjithashtu, në ankesë përmendet edhe ish-gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, I. H, i cili ka dhënë vendimin në shkallën e parë, si dhe dy anëtarët e tjerë të trupës së Gjykatës së Apelit Tiranë, që kanë gjykuar çështjen, konkretisht gjyqtarët F. I dhe M. Q. Ankuesi ka parashtruar se i është drejtuar me ankesë KLGJ-së, për faktin se kjo e fundit, pas shqyrtimit të kandidatave për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë nga radhët e gjyqtarëve, ka vendosur ndër të tjera, kualifikimin e kandidatit A. V. Sipas ankuesit, ky gjyqtar është kallëzuar penalisht prej tij pasi ka kryer grabitje të qytetarit me vendim të formës së prerë, në shpërdorim të detyrës.
- 1.4 ILD me Vendimin nr. {\*\*\*}Prot, datë 26.05.2021, ka vendosur arkivimin, pas shqyrtimit fillestar të ankesës nr. {\*\*\*}Prot., datë 23.12.2020, të paraqitur nga shtetasi Hasan Roqi, me argumentin se ankesa nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë, referuar afatit të parashkrimit, subjektit ndaj të cilit drejtohet si dhe referuar natyrës së pretendimeve, të parashikuara nga neni 117 dhe 120/1, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- 1.5 Vendimi i ILD i është njoftuar ankuesit, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2021. Në vendim, si edhe në njoftimin e vendimit për arkivimin e ankesës, ILD i ka bërë me dije ankuesit se në përputhje me nenin 121, pika 3, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka të drejtë të ankimojë vendimin në KLGJ brenda një jave nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.
- 1.6 Kërkuesi Hasan Roqi në datë 31.05.2021 ka paraqitur në KLGJ ankim ndaj vendimit të ILD nr. {\*\*\*}Prot., datë 26.05.2021, duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2021 të ILD, si dhe të vendosë shkarkimin nga detyra të magjistratit A.V.
- 1.7 Kërkuesi Hasan Roqi i është drejtuar përsëri KLGJ, në datë 22.08.2021, duke kërkuar kopje të vendimit të Komisionit Disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, lidhur me ankesën e tij.
- 1.8 Kërkuesi Hasan Roqi ka paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, i cili është regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor me (JD) nr. 7/2021, datë 15.10.2021.

## **II. Pretendimet e kërkuessit**

Kërkuessi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë për shkak të lënies në fuqi heshturazi pa vendim njoftimi, nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës në KLGJ, të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2021, të Zyrës së ILD, në lidhje me magjistratin A.V. Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

- 2.1 Vendimi i ILD nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2021, në lidhje me magjistratin A. V, lënë në fuqi pa vendim njoftimi nga KLGJ, është një vendim në përkrahje të pandëshkueshmërisë, mungesës së transparencës, ndikimit politik dhe korrupsionit.
- 2.2 Magjistrati me vendimin e tij nr. {\*\*\*}, datë 13 shtator 2017, nuk ka respektuar përmbajtjen e vendimit nr.76, datë 08.10.2000 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nuk ka zbatuar nenin 81, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit “*Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal*”.
- 2.3 ILD dhe Komisioni i Disiplinës në KLGJ nuk i kanë hyrë në themel verifikimit të ankimit, sipas ligjit, për shkeljen nga ana e magjistratit të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që ka 21 vjet pa u ekzekutuar. Magjistrati, duke marrë kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe Këshillit të Ministrave në interpretimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Udhëzimit nr.3 datë 21.06.1993, ka kryer vepra penale si përvetësim titulli apo i detyrës shtetërore, sipas nenit 246 të Kodit Penal, shpërdorim detyre, sipas nenit 248 të Kodit Penal, dhe kryerje të veprimeve arbitrare sipas nenit 246 të Kodit Penal.
- 2.4 Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2021, i ILD është i paarsyetuar dhe kontradiktor. Duke arkivuar ankimin ILD ka pranuar si të ligjshme shkeljen e drejtpërdrejtë të Kushtetutës, ligjit të posaçëm, Udhëzimit nr.3, datë 21.06.1992 të Këshillit të Ministrave, vendimit të formës së prerë nr. {\*\*\*}, datë 08.10.1997, të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimit nr.76/2000 të Gjykatës Kushtetuese që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë.

## **III. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraprak**

### **A. Për juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

3.1. Juridiksioni dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, janë parashikuar në nenin 179, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilit:

*“Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të*

*Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.”*

3.1.2. Në Vendimin Nr. 2/2018 (JD), datë 21.06.2018, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vlerësuar se shqyrtimi i të gjitha ankesave apo kërkesave të paraqitura e të regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelit në kuadër të Juridiksionit të tij Disiplinor, do të gjykohe sipas dispozitave të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, për sa i përket natyrës e procedurës së gjykimit. Kolegji, në këtë mënyrë, i ka konsideruar këto kërkesa si një gjykim kushtetues, të ndryshëm për nga natyra me gjykimin që Kolegji i Posaçëm i Apelit bën në rastet kur ai gjykon sipas juridiksionit të tij rivlerësues. Ky i fundit ka tiparet e një procesi që ndërthur natyrën administrative me elementet kushtetuese.

3.2. Nën dritën e parashikimeve të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak vlerëson nëse plotësohen kushtet për gjykimin e çështjes në analizë të aspekteve formale të kërkesës, sipas nenit 27, dhe në analizë të plotësisht individualisht të kriterëve të cilët mund të passjellin moskalimin e çështjes në seancë plenare, përcaktuar në nenin 31/a të të njëjtit ligj.

3.2.1. Në zbatim të sa më sipër, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak konstaton se kërkesa objekt shqyrtimi plotëson të gjitha elementet e formës të përshkruara në pikën 2 të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000<sup>1</sup>.

3.2.2. Për sa u përket rregullimeve të veçanta të shqyrtimit paraprak të kërkesës, që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, me legjitimitimin formal të kërkuarit dhe përfaqësuesit, si dhe me respektimin dhe vlerën e vendimmarrjeve të mëparshme të Gjykatës, parashikuar në nenin 31/a të ligjit nr. 8577<sup>2</sup>, kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen bashkërisht. Me fjalë të tjera, mosplotësimi i njërit prej kriterëve sjell si pasojë moslegjitimitimin e kërkesës për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

---

<sup>1</sup> Pika 2 e nenit 27 të ligjit nr. 8577 përcakton që “[...] 2. Kërkesa paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit në gjykim dhe duhet të përmbajë: a) emrin dhe adresën e Gjykatës Kushtetuese; b) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vend-banimin ose vendqëndrimin e kërkuarit dhe/ose të përfaqësuesit; c) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vend-banimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara dhe/ose të përfaqësuesve; ç) objektin e kërkesës dhe bazën ligjore; d) parashtrimin e shkaqeve dhe shkeljet e natyrës kushtetuese të pretenduara; dh) dokumentet, provat, apo materiale të tjera që shoqërojnë kërkesën; e) kopje të noterizuara të të gjitha vendimeve objekt kërkesë, si dhe të ankimeve dhe rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore; ë) nënshkrimin e kërkuarit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe aktin e përfaqësimit të këtij të fundit [.]”

<sup>2</sup> Neni 31/a parashikon: “[...] 2. Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur: a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; b) kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet; c) kërkesa është paraqitur nga një person i paautorizuar; ç) vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor; d) kërkuari nuk ka shtuar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion; dh) kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur; e) kërkesa është haptazi e pabazuar.”

3.2.3. Kërkesa e ushtruar, duke pasur për objekt *konstatimin e pavlefshmërisë së lënies në fuqi heshturazi pa vendim njoftimi*, nuk rezulton të ketë për objekt asnjë prej akteve të cilët mund të ankimohen në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, në kuadër të juridiksionit disiplinor, përcaktuar shprehimisht nga Kushtetuta, ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Konkretisht, nga dispozitat e Kushtetutës dhe të ligjeve të mësipërme, rezulton se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në kuadër të juridiksionit disiplinor, shqyrton:

- Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj magistratëve;<sup>3</sup>
- Vendimet e ILD për masat disiplinore të vendosura ndaj inspektorëve të tjerë;<sup>4</sup>
- Vendimet e ILD për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë<sup>5</sup>.

### ***B. Vlerësimi i pretendimeve të kërkuarit***

3.3. Siç është shtjelluar edhe më sipër në paragrafin 3.2.3, konstatohet se kërkuari i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit duke kërkuar *“konstatimin e pavlefshmërisë së lënies në fuqi heshturazi pa vendim njoftimi, nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës në KLGJ të vendimit nr. {\*\*\*} datë 26.05.2021 të Zyrës së ILD.”*

3.3.1 Kërkesa e paraqitur qartazi nuk ankimon vendimin e ILD për arkivimin e ankesës. Kërkuari shprehet për konstatimin e pavlefshmërisë për shkak të rrethanave që sipas tij përbëjnë *lënie në fuqi heshturazi pa vendim njoftimi* të vendimit të ILD, nr. {\*\*\*} datë 26.05.2021, nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës në KLGJ. Pavarësisht se në përmbajtje të kërkesës shprehen edhe pretendime për paligjshmërinë e vendimit në fjalë të ILD, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak është i detyruar t’i pëmbahet objektit të kërkesës së paraqitur që nuk ka për objekt kundërshtimin e një vendimi.

3.3.2 Lidhur me verifikimin e ankesave të paraqitura pranë ILD dhe ankimin në KLGJ të vendimeve të ILD, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 122, pika 5, parashikohet se: *“5. Vendimi [...] për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.”*

---

<sup>3</sup> Parashikuar në nenet 140, 148/d dhe 179, pika 7, të Kushtetutës, neni 100, pika 1 dhe 192, pika 1, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 147 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>4</sup> Neni 179, pika 7, e Kushtetutës.

<sup>5</sup> Nenet 6 dhe 104 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, neni 119 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3.3.3 Siç rezulton dhe nga aktet që shoqërojnë kërkesën, pas njoftimit të marrë nga ILD në datë 26.05.2021, kërkuesi e ka ankimuar vendimin e ILD nr. {\*\*\*}, për arkivimin e ankesës, pesë ditë më pas, në datë 31 maj 2021, që nënkupton brenda afatit një javor të parashikuar në dispozitën e sipërcituar. Kërkuesi pretendon se Komisioni i Përkohshëm në KLGJ, ose Komisioni Disiplinor siç shprehet ai, krijuar sipas parashikimeve të nenit 62, pika 13,<sup>6</sup> të ligjit nr.115/2016, nuk ka marrë një vendim lidhur me ankimin e paraqitur prej tij.

3.3.4. Pas regjistrimit të kërkesës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.11.2021, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka kërkuar informacion nga KLGJ, nëse ka pasur një vendimmarrje për ankesën e paraqitur nga kërkuesi Hasan Roqi. Më datë 10.11.2021, KLGJ, me shkresën nr. {\*\*\*}prot., ka informuar Kolegjin e Posaçëm të Apelimit se Komisioni i Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër Vendimeve të ILD për Arkivimin ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.10.2021, ka vendosur refuzimin e ankimit të paraqitur nga z. Hasan Roqi, kundër vendimit nr. {\*\*\*}prot., datë 26.05.2021 të ILD, si të pabazuar. Një kopje e arsyetuar e këtij vendimi është urdhëruar t'i njoftohet, ndër të tjerëve, dhe ankuesit. KLGJ njofton edhe që ankuesi është informuar që ky vendim është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankim. Përpos sa më sipër, ankuesi Hasan Roqi pranon që është në dijeni të vendimit {\*\*\*}, datë 27.10.2021 të Komisionit të Përkohshëm në KLGJ, siç rezulton nga një kërkesë e paraqitur prej tij pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në datë 08.11.2021.

3.3.5 Në përfundim të sa më sipër, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak konstaton se ankimi i kërkuetit ndaj vendimit të ILD, nr. {\*\*\*}, datë 26.05.2021, është shqyrtuar në KLGJ, ndërsa pretendimi për mungesë vendimmarrjeje të Komisionit të Përkohshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk qëndron.

3.4. Kërkuesi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me kërkesën për vendosjen para përgjegjësisë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, subjekt i interesuar. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak sjell në vëmendje që Kolegji i Posaçëm i Apelimit sipas nenit 6 të ligjit 115/2016, shqyrton ankimet kundër vendimeve të ILD për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kolegji mund të fillojë një procedurë disiplinore ndaj anëtarit të Këshillit *vetëm* pas përfundimit të hetimit nga ILD.

3.4.1 Në rastin konkret, rezulton që kërkuesi i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për vendosjen para përgjegjësisë disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shqyrtimi i kërkesave të kësaj natyre përbën një nga tagrat e ILD, i cili është organi përgjegjës për shqyrtimin fillestar të ankesave, për vlerësimin, verifikimin, hetimin mbi bazën e ankesës, për arkivimin e ankesës, mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Konkretisht, sipas nenit 194 të ligjit 115/2016, ILD vihet në lëvizje për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj

---

<sup>6</sup> Kjo dispozitë parashikon si vijon: “[13.] Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të ILD për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, **krijohet një komision i përkohshëm** i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit [...]”

gjqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bazuar në ankimin me shkrim të çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar.

3.4.2. Gjithashtu, Kolegji sjell në vëmendje që procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor fillon pas depozitimit të një ankese nga individë apo persona fizikë e juridikë të interesuar, dhe vijon, nëse është rasti, me kryerjen e hetimit disiplinor nga ILD. Në varësi të vendimmarrjes së ILD, procedimi disiplinor mund të mbërrijë në Gjykatën Kushtetuese ( *Kolegji i Posaçëm i Apelit brenda mandatit të tij nëntëvjeçar*). Konkretisht, neni 6 i ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në pikat 1 dhe 4, parashikon se:

*“1. Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor hetohen nga ILD, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë [...]”*

*[4.] Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të këtij ligji, të ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””.*

3.4.3 Nën dritën e sa më sipër, në kushtet kur ILD nuk ka zhvilluar një procedurë hetimi disiplinor, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak konstaton që kërkesa nuk mund të pranohet pasi kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike që parashikon legjislacioni në fuqi për paraqitjen e ankimit ndaj veprimtarisë së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3.5. Edhe pretendimi i kërkuetit për dhënien e masës disiplinore nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për magjistratin A. V nuk qëndron. Sipas nenit 147/a të Kushtetutës, është KLGJ që vendos masat disiplinore ndaj gjyqtarëve magjistratë, pas përfundimit të procesit të hetimit nga ILD. Kolegji i Posaçëm i Apelit, sipas nenit 179, pika 7, të Kushtetutës, nuk jep masa disiplinore ndaj magjistratëve por shqyrton ankimet ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore për magjistratët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

3.6.Lidhur me pretendimet e tjera të kërkuetit për vendosjen e masës së ndalimit të tre pagave mujore për llogari të kërkuetit ndaj tre anëtarëve të Komisionit Disiplinor në KLGJ, dhënien e garancisë procedurale nga Komisioni i Posaçëm i Apelit, në mbrojtje të ekzekutimit të të drejtave që rrjedhin nga vendimi nr.76, datë 08.11.2000, i Gjykatës Kushtetuese, shpërblimi i dëmit financiar dhe moral për 4 vite nga ana e magjistratit A. V si dhe publikimin në median publike dhe në Shkollën e Magjistraturës si kasus, të vendimit nr. {\*\*\*} datë 13 shtator 2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak vlerëson se këto pretendime nuk i takojnë sferës së çështjeve që përfshihen në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

3.7. Në përmbledhje të sa më sipër, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në parashikimet e nenit 31, pika 3, e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i



ndryshuar, si dhe të nenit 31/a, pika 2, shkronja “a” të po këtij ligji, çmon se kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk janë në kompetencën dhe juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, bazuar në nenin 31 dhe në nenin 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VENDOSI:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 20.12.2021.

**Rezarta SCHUETZ**

**Natasha MULAJ**

**Ina RAMA**

**ANËTARE**

**ANËTARE**

**ANËTARE**

*nënshkrimi*

*nënshkrimi*

*nënshkrimi*